



Buletini Informativ

- * Hyrje
- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar
 - * Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)
- * Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
 - * Aktivitetet për Trajnimin e Trajnuesve

Nëntor 2020

Hyrje

Ngritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve duke përfshirë edhe profesionistët e tjerë ligjor ka vazhduar edhe gjatë muajit nëntor përmes platformës online Zoom si dhe eleraning, përkatësisht kurset e mësimit në distancë.

Muaji nëntor karakterizohet me një mori aktiviteteve trajnuese të fokusuara vetëm tek trajnimet e vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë si dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial meqë Programi Fillestar vazhdon përgatitjet për gjeneratën e re të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët priten fillimisht të dekretohen.

Përmes këtij buletini informativ në vijim pasqyrohen takimet nga bashkëpunimi ndërinstytucional, me donatorët dhe projektet me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta, aktivitetet në dobi të hartimit të programit trajnues për vitin 2021-2022, aktivitetet e realizuara nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme të specifikuara sipas temës së trajnimit, kohëzgjatjes dhe përfituesve të saj si dhe trajnimit të trajnuesve për drejtësinë komerciale.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, buletini informativ përmban edhe njoftimin dhe zhvillimet sa i përket kurseve trajnuese të realizuara në platformën e mësimit në distancë gjatë muajit nëntor.

Aktivitetet të përgjithshme

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e përbashkëta me donatorët dhe projektet

Gjatë muajit nëntor është vazhduar bashkëpunimi qoftë me institucionet vendore ashtu edhe koordinimi me donatorët. Me qëllim të koordinimit të punëve të përbashkëta janë realizuar takime, punëtori, konferenca dhe aktivitetet tjera si në vijim:

AD ne kuadër të vlerësimit të nevojave për trajnime, në një takim pune ka pritë anëtarët e Komisionit për Trajnime të KGJK-se, ku mes tjerash është biseduar edhe për kolizionin e akteve nënligjore të KGJK se dhe AD, mandatin, trajnimet, vlerësimin e trajnimeve si dhe ndërveprimin e përgjithshëm në fushën e trajnimeve.

AD ka marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Transfere i Kuvendit të Republikës së Kosovës në të cilin është prezantuar raporti vjetor financiar për vitin 2019. Raporti është vlerësuar nga anëtarët, ku pas disa komenteve është votuar unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent.

AD ka vazhduar me takimet e rregullta javore me përfaqësuesin e projektit të BE / EKOJUST, z. Dragomir Yordanov. Gjatë takimeve është diskutuar procesi i AD-se për zhvillimin dhe hartimin e programi trajnues kornize, rishikimi funksional i sektorit të ligjit dhe nevojat për koordinimin ndërmjet AD, OPDAT dhe EKOJUST. Në sesionet punuese të hartimit të programit trajnues, kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e projektit në fjalë. Në takimet e radhës është diskutuar plani i punës së projektit dhe aktivitetet që do të ndërmerren në projektin në mbështetje të AD-së, si dhe nevojat dhe sfidat e AD-se në përmbushjen e mandatit ligjor. Gjithashtu është diskutuar edhe mundësia e mbështetjes së projektit në ngritjen e kapaciteteve të AD-së në udhëheqjen, organizimin dhe vlerësimin e

programeve trajnuese. Në takimin koordinues mes AD-së, OPDAT dhe Projektit të EU / EKOJUST , kryesisht është diskutuar koordinimi i aktiviteteve në mbështetje të AD -së , fushat që do të mbulohen nga secila palë dhe shkëmbimi i informatave në lidhje me avancimin dhe fuqizimin e AD-së .

AD ka marrë pjesë në takimin e trete të Këshillit Drejtues të projektit KoSEJ II, ku ka prezantuar të arriturat dhe sfidat në asistencën e këtij projekti

AD është takuar edhe me përfaqësuesit e projektit të UNDP-së në lidhje me koordinimin e aktiviteteve në fushën e trajnimeve për gjyqtarët dhe prokuroret në temën e pastrimit të parave. Për këtë është zhvilluar takim i përbashkët me ekspertin ndërkombëtar të angazhuar nga projekti. Në takim është diskutuar ngritja, profesionalizmi dhe trajnimi i prokuroreve dhe gjyqtareve në parandalimin e pastrimit të parave, ku është rekomanduar të përfshihen edhe zyrtarët hetues të njësive të specializuara policore

AD në vazhden e bashkëpunimit ndërinstitucional, ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” e cila krijon mundësinë e ofrimit dhe shkëmbimit të përvojave dhe trajnimeve.

Gjatë muajit nëntor janë realizuar katër sesione për hartimin e Programit Trajnues Kornize 2021-2022. Sesionet punuese janë realizuar me përfshirjen e eksperteve dhe anëtareve të Këshillit Programor të AD ku janë identifikuar temat e trajnimit sipas fushave dhe prioriteteve të dala nga vlerësimi i nevojave.

AD ka mbajtur takimin e radhës së Këshillit Programor, ku është diskutuar drafti i programit trajnues kornizë 2021-2022. Pas rishikimit të draftit, anëtarët e komisionit me disa komente shtesë kanë vlerësuar se drafti i prezantuar i plotëson të gjitha nevojat dhe adreson gjitha temat me prioritet dhe rekomandon Këshillin Drejtues të AD që të aprovojë si të tillë.

AD ka marr pjesë në takimin e radhës së Ekipit Qendror Punues për Hartimin e Projekt Strategjisë Sektoriale të Sundimit të Ligjit, ku janë diskutuar hapat e mëtejshëm në hartimin e strategjisë finale.

Në vazhden e bashkëpunimit me projektet me donatorë janë realizuar trajnime të shumta si në vijim: Programin e USAID'it – Drejtësia Komerciale, trajnimi “Ndërmjetësimi”. Me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës zyra OPDAT në Kosovë “Shkathësitë e përfaqësimit në gjykim” dhe “Sesioni 3 - Trafikimi përmes internetit. Në kuadër të bashkëpunimit me projektin CEL (Center for Equality and Liberty Kosova) trajnimi me temë “Avancimi mbi të drejtën e personave LGBTI në Kosovë”. Në bashkëpunim me Organizatën ndërkombëtare të punës (ODBE) punëtorja me temë: “Angazhimi i fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara”. Në bashkëpunim me

projektin e BE Mbështetje e Kodit Civil Faza 2 punëtorja me temë “Tryezë me gjyqtarë dhe avokatë Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështje civile”. Në bashkëpunim me Programin e USAID'it – Drejtësia Komerciale, ka zhvilluar programin e trajnimit për trajner TT në fushën komerciale.

AD ka marr pjesë në takimin e Komitetit Drejtues të Projektit – programi i mentorimit i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, projekti për Forcimin e sistemit të Drejtësisë në Kosovë. Në takim është prezantuar raporti i projektit ku AD është falënderuar për bashkëpunimin në realizimin e dy sesioneve nga dy ditë trajnim të realizuara nga projekti.

AD ka mbajtur takimin e radhës të Këshillit Drejtues të AD -së. Në takim, anëtarët e KD-së aprovuan unanimitisht Programin Trajnues Kornizë 2021-2022, gjithashtu zgjedhën zëvendës Kryesuesin e KD -së dhe plotësuan edhe me një anëtarë Komisionin për Çështje Normative, ku nga katër sa kishte tashme do të jenë 5 anëtarë.

Marrëveshje Bashkëpunimi mes Akademisë së Drejtësisë dhe Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” – Fakulteti Juridik

Me 06 Nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë dhe Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” – Fakulteti Juridik, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.



Qëllimi i marrëveshjes është përcaktimi i bashkëpunimit reciprok në mes të dy (2) palëve, për të përkrahur objektivat e tyre strategjike si dhe mbështetja dhe bashkërendimi i aktiviteteve në sferën e hulumtimit, studimit dhe shkëmbimit të praktikave më të mira profesionale.

Marrëveshja e nënshkruar do të shtrihet në disa fusha specifike si: shkëmbimi i informacioneve dhe materialeve profesionale dhe akademike, ngritja profesionale e studentëve të fakultetit juridik përmes praktikave në Akademi, mbajtja e përbashkët e tribunave, konferencave, simpoziumeve, organizimi i hulumtimeve të përbashkëta në zhvillimin e kurrikulave trajnuese sidomos në pjesët e metodologjive të ligjërimit etj.

Kjo marrëveshje vije si rrjedhojë e memorandumeve të bashkëpunimit të cilat është duke i krijuar Akademia e Drejtësisë me institucionet tjera akademike me të cilat ka interesa të përbashkëta, me qëllim të përmbushjes së misionit dhe funksionit të saj ligjor



Punëtoritë për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2021-2022

Më 09-10 nëntor si dhe 12-13 nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë realizoi dy punëtori për hartimin e Programit Trajnues për vitin 2021-2022”.

Qëllimi i punëtorive ishte hartimi i Programit Trajnues për vitin 2021-2022, adekuat me nevojat reale të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe në përgjithësi me sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës si dhe përcaktimi i prioritetëve për çështjet ligjore që duhet trajtuar në vitin 2021.

Me rastin e këtyre punëtorive paraprakisht janë prezantuar zhvillimet gjatë vitit 2020 me fokus te përmbushja e programit sipas planifikimit, sesionet trajnuese të realizuara, vijueshmëria në trajnime si dhe çështje tjera me rëndësi sa i përket aspektit të trajnimeve. Në vazhdim janë prezantuar të gjeturat nga procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese, temat e propozuara nga mekanizmat e ndryshëm si dhe angazhimet e Akademisë për ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përmbushjen e kërkesave që dalin nga proceset euro integruese.

Nevoja për trajtimin me prioritet të disa nga institutet e ndryshme të së drejtës të cilat në praktikën gjyqësore nuk po zbatohen drejtë, e gjithashtu edhe luftimi i kriminalitetit për forma të ndryshme të veprave penale për të cilat Kosova nuk po e merre vlerësimin e mirë për sundimin e ligjit ishin përcaktuese për kurrikulën trajnuese për vitin 2021. Më tej, gjatë këtyre punëtorive ekspertët e angazhuar

për hartimin e programit të ndarë në grupe varësisht prej fushave: civile, penale, administrative, ekonomike duke përfshirë edhe të drejtat e njeriut, kompetencën ndër personale dhe interdisciplinare kanë zhvilluar konceptet e trajnimit duke u mbështetur në kërkesat Akademisë së Drejtësisë për strukturën dhe elementet që duhet të përmbajnë konceptet e trajnimit.

Vëmendje të veçantë përveç përcaktimit të prioritetëve për vitin 2021 dhe zhvillimit të koncepteve ka pasur edhe metodologjia trajnuese. Gjatë punëtorisë u përcaktua që një mori çështjesh ligjore të adresohen përmes tryezave të cilat do të reflektojnë në evitimin e shkaqeve për lëndët që kthehen në rigjykim për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe praktikës jo unifikuese.

Në draft programin trajnues janë përfshirë edhe temat e propozuara nga partnerët e Akademisë me theks në fushën e Lirisë së shprehjes, Drejtësisë komerciale, për Kodin Civil, si dhe nga fusha penale, përkatësisht ato që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin trajnuesit e përhershëm dhe trajnuesit Akademisë së Drejtësisë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga gjitha nivelet.

Takimi i Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë

Më 13 nëntor 2020, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Programor të AD-së.

Në fokus të këtij takimi, si pikë kryesore ishte diskutimi dhe shqyrtimi i draft Programit Trajnues Kornizë 2021/2022.

Gjatë takimit, anëtarët e Këshillit Programor diskutuan lidhur me përmbajtjen, strukturën, temat e përfshira në Programin Trajnues 2021/2022, metodologjinë e realizimit të trajnimeve, kohëzgjatjen e sesioneve të

trajnitimit, si dhe për çështje tjera të rëndësishme për zbatimin e këtij programi trajnues.

Këshilli Programor përveç rishikimit të draft-Programit Trajnues Kornizë 2021/2022, dhanë edhe rekomandimet e tyre, për përfshirjen e disa temave shtesë, njëkohësisht largimin e atyre që janë konsideruar si më pak të nevojshme, rekomandime këto të cilat do t'i prezantohen Këshillit Drejtues të AD-së për diskutim dhe miratim.



Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Më 30 nëntor 2020, në Akademinë e Drejtësisë, është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues z. Enver Peci, Kryetar i Gjykatës Supreme.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe miratimi i Programit Trajnues Kornizë për vitin 2021-2022 të AD-së, si dhe çështje tjera në kuadër të mandatit të Akademisë.

Sipas agjendës së përcaktuar për këtë takim, fillimisht anëtarët e Këshillit Drejtues zgjedhën zv. kryesuesin e Këshillit Drejtues, me këtë rast me vota unanime, zv. kryesuese e Këshillit Drejtues të AD-së u zgjedh znj. Javorka

Perlinčević, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Në vijim anëtarët e KD-së shqyrtuan dhe miratuan Programin Trajnues Kornizë për vitin 2021-2022, së bashku me propozimet dhe rekomandimet e Këshillit Programor.

Në këtë takim Këshilli Drejtues diskutoi edhe çështje të tjera të cilat janë në dobi të funksionimit të mirë të punës së Akademisë së Drejtësisë në kuadër të kompetencave dhe mandatit ligjor të saj.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Hartimi i moduleve trajnuese

Edhe gjatë muajit nëntor është vazhduar me përgatitjet për trajnimin fillestar për gjyqtarët që priten të dekretohen së shpejti meqë 22 kandidatë potencial për gjyqtarë i kanë kaluar gjitha fazat e rekrutimit në KGJK.

Prandaj, Akademia e Drejtësisë është në proces të hartimit të moduleve trajnuese sipas përmbajtjes së përcaktuar nga ky program, si dhe materialet tjera përcjellëse.

Në periudhën raportuese janë finalizuar modulet si në vijim: Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinore si dhe Legjislacioni dhe Shkathtësitë plotësuese ndërkaq janë në proces të finalizimit moduli për Kodin Penal dhe

Kodin e Procedurës Penale si dhe moduli për të drejtën civile, administrative dhe ekonomike.

Po ashtu është vazhduar me procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimit të programit trajnues për prokurorët e rinj për të cilët ka filluar procesi i rekrutimit nga KPK.

Bazuar në metodologjinë për vlerësim të nevojave trajnuese ky proces është në fazën e përpunimit të propozimeve të dala nga mekanizmat vlerësues.

Trajnimi: Mjetet e rrëzimit të vendimeve pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme

.Më 05 nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, përmes platformës elektronike Zoom realizoi trajnimin me temë “ Mjetet e rrëzimit të vendimeve pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës”.

Qëllimi i këtij sesi trajnues ishte ngritja e njohurive të pjesëmarrësve rreth Procedurës gjyqësore për rrëzimin e vendimeve të Agjencisë, që dalin nga procesi i privatizimit dhe likuidimit.


Gjatë këtij trajnimi u trajtuan procedurat gjyqësore për rrëzimin e vendimeve të Agjencisë, që dalin nga procesi i privatizimit dhe likuidimit, duke shtjelluar në mënyrë të hollësishme se në procedurën gjyqësore kujt mund ti drejtohet ankesa, cilat janë shkaqet për ushtrimin e ankesës, çka duhet të përmbajë,

ankesa /kërkesa si dhe cilët janë kufijtë e shqyrtimit të ankesës apo kundërshtimit.

Më tej u diskutua për dispozitat ligjore lidhur me kufijtë e ekzaminimit të ankesës apo kundërshtimit si dhe afatet ligjore për paraqitjen e ankesës apo kundërshtimit.

Metodologjia e trajnimit ishte bazuar në diskutime interaktive, me raste praktike sa i përket aspektit të mjeteve të rrëzimit të vendimeve pranë Dhomës së Posaçme, duke bërë edhe shtjellimin e tyre përmes dhënies së mundësisë për pjesëmarrësit që të japin mendimet e tyre rreth kësaj çështje.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtar nga gjykatat themelore, divizioni civil.



Trajnimi: Trafikimi për qëllime të shfrytëzimit për punë të detyruar

Më 05 nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Drejtësisë/OPDAT, organizoj trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Trafikimi për qëllime të shfrytëzimit për punë të detyruar”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë për format e ndryshme të rekrutimit të trafikimit për shfrytëzim për punë të detyruar dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore në rastet e tilla ligjore.

Në sesionin e parë gjatë trajnimit u trajtuan çështjet që kanë ë bëjnë me shenjat e zakonshme të trafikimit të punës, mbështetja e deklaratave të viktimave me prova duke i elaboruar këto përmes rasteve të studimit e gjithashtu edhe përmbledhje të viktimologjisë së trafikimit me njerëz si dhe hetimet e qendërsuara tek viktimat

Me rastin e këtij trajnimi u ofruan shembuj të

rasteve të trafikimit për shfrytëzim të punës përmes të cilave u elaboruann format e rekrutimit, strehimit, transportimit, sigurimin ose marrjen e personit për punë ose shërbime, duke përdorur forcë, mashtrim apo shtrëngim, për ta nënshtruar atë ndaj robërisë së pavullnetshme, varësisë së borxhit ose skllavërisë.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, paraqitja e këndvështrimeve të pjesëmarrësve, prezantimi përmes PowerPoint, pyetje-përgjigjet dhe analizimi i rasteve nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë nga Gjykatat Themelore, prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të shtetit dhe nga Prokuroritë Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës, mbrojtës të viktimave nga Zyra e Avokatit të Viktimave, zyrtarë policor nga Njësia për Hetimin e Njësisë së Trafikimit me Njerëz, dhe staf administrativ nga gjyqësori dhe prokuroria.

Ku ndodhë trafikimi për shfrytëzim të punës

Ndodhë në mjedise të ndryshme të punës:

- Punë shtëpiake
- Biznese të vogla
- Ferma të mëdha
- Fabrika

© PROSECUTOR

Trajnimi: E drejta e ndërtimit dhe qiraja afatgjate në tokë

Më 06 Nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e BE Mbështetje Kodit Civil Faza 2, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë “E drejta e ndërtimit dhe qiraja afatgjate në tokë”.

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me risit dhe ndryshimet që sjell Kodi Civil për të drejtën e ndërtimit.

Në pjesën e parë të trajnimit u diskutua për zbatimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e ndërtimit dhe dallimin me institutet tjera të ngjashme, rregullimin aktual ligjor, lidhshmëria me kontratën e ndërtimit dhe dallimet.


Ndërsa në pjesën e dytë u theksua se në praktiken gjyqësore ka mjaft raste për çështje të drejtës së ndërtimit, sidomos rastet e ndërtimit të ndërtesave të banimit, investimeve të ndryshme nga bizneset, blerjet e tokave dhe kthimi në investime ose konvertimi në banesa.

Andaj, në mënyrë të hollësishme nga trajnuesit u shtjellua baza ligjore se si i ka rregulluar ligji në fuqi të drejtën e ndërtimit dhe risitë që sjell Kodi civil.

Në kuadër të këtij trajnimi fokusi ishte në unifikimin e vendimeve të gjykatave për rastet e të drejtës së ndërtimit si dhe perspektiva e zbatimit të ligjit në të ardhmen.

Për realizimin e këtij trajnimi u përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik dhe i dispozitave ligjore në fuqi dhe ato që priten në të ardhmen (Kodi Civil), prezantime në Power Point, diskutimet interaktive përmes rasteve dhe shqyrtim i përbashkët i mënyrës së zbatimit të dispozitave ligjore në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtar nga të gjitha Regjionet e Kosovës.



Trajnimi: Intervistimi forenzik i fëmijëve

Më 09-10-11-12 nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me OSCE, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme-së ka realizuar trajnimin me temë “Intervistimi forenzik i fëmijëve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i shkathtësive profesionale të gjyqtarëve për të mitur, prokurorëve për të mitur si dhe të zyrtarëve tjerë në zbatimin e drejtë të intervistimit forenzik të fëmijëve të cilat kanë qenë viktime të krimit nga madhorët.

Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom u trajtua Intervistimi forenzik i fëmijëve, grumbullimi i provave, nevoja e hartimit dhe përdorimit të protokollit për intervistimin e fëmijëve viktime apo dëshmitarë. Paraprakisht

vëmendje parësore iu kushtua përgatitjes së viktimave fëmijë për gjykim, metodave teknike dhe taktike të intervistimit të viktimës si dhe të dyshuarit. Njëkohësisht, u analizuan teknologjia dhe zgjidhja e rasteve si dhe hetimi i pornografisë së fëmijëve duke përfshirë edhe elaborimin e legjislacionit vendor atë material dhe procedural që e rregullojnë këtë fushë mjaft të ndjeshme për shoqërinë në tërësi.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi janë: gjyqtarë, prokuror, mbrojtës të viktimave dhe zyrtarë policor.



Trajnimi: Zbatimi i Ligjit për zyrtarët publik

Më 10, 11 dhe 13 Nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e GIZ/LARP në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Zbatimi i ligjit për zyrtarë publik”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve tjerë ligjor për Ligjin për zyrtarë publikë dhe zbatimi i drejtë i tij në praktikë.


Gjatë këtij trajnimi u fillua me trajtimin e Ligjit për zyrtar publik në vështrim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për zyrtar publik në raport me sistemin e drejtësisë, vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Ligjit për zyrtar publik në raport me institucionet e pavarur si dhe

Gjykatën Kushtetuese.

Më tej u vazhdua me dispozitat që kanë ë bëjnë me procedurën para organit administrativ me rastin e punësimit për shërbyes civil, klasifikimi i zyrtarëve dhe të drejtat e zyrtarëve publik, klasifikimi i vendeve të punës në shërbimin civil si dhe masat disiplinore dhe menaxhimi i kontesteve.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive duke shtjelluar edhe raste të ndryshme nga praktika gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtar, prokuror dhe zyrtar ligjor.



Trajnimi: Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në lëmine penale

Më 12 nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin IRZ në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar - në lëmin penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në procedurën penale.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan: Urdhëresat e lëshuara për paraburgim për personat e kërkuar, kërkesat për caktimin e paraburgimit për personat e kërkuar nga shteti kërkuar, aktvendimet për caktimin e paraburgimit dhe kohëzgjatja e tyre, aktvendimi për lejimin e ekstradimit të personit të kërkuar si dhe njohja dhe ekzekutimi i aktgjykimeve të huaja.

Në vazhdim u veçua mendimi se qëllimi kryesor i këtij trajnimi është njohja e bazës

ligjore të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në Kosovë, zbatimi i dispozitave ligjore lidhur me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale, për shkak të rëndësisë së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe rolin e tyre për veprim të shpejtë tek këto raste.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën mundësi që përmes materialit të ofruar nga trajnuesit, diskutimeve, analizës së rasteve studimore, t'i zbërthejnë drejtë dispozitat ligjore lidhur me Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar.

Vëmendje të veçantë gjatë trajnimit kishin rastet nga praktika gjyqësore dhe mënyra të vendosjes meritore në raste konkrete.

Përfitues të këtij trajnimi janë: Gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Trajnimi: Sesioni 2 Trafikimi i fëmijëve dhe të rriturve për qëllime seksuale

. Më 12 nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Drejtësisë/OPDAT, ka realizuar trajnimin online përmes platformës Zoom me temë “Trafikimi me qëllim të shfrytëzimit seksual dhe çështjet që ndërlidhen me viktimat fëmijë dhe të mitur”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë lidhur me shfrytëzimin seksual të viktimave dhe të miturve si dhe zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore në zgjidhjen e këtyre rasteve.

Gjatë këtij trajnimi u trajtua trafikimi me njerëz e cila konsiderohet të jetë një ndër krimet më serioze e cila paraqitet si formë bashkëkohore e skllavërisë me shkeljen e të drejtave themelore të njeriut, të drejta këto që janë të garantuara si me të drejtën vendore ashtu edhe në atë ndërkombëtare. Në vazhdim janë trajtuar format e trafikimit si transportimi, transferimi, strehimit ose pranimit i personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave

të tjera të detyrimit me qëllim të shfrytëzimit të njerëzve.

Vëmendje të veçantë iu kushtua trafikimit të femrave e cila rezulton si një prej formave më të shpeshta të trafikimit me qëllim të përfitimit dhe shfrytëzimit seksual duke vënë në pah vendet e zakonshme të trafikimit për shfrytëzimin seksual siq janë kazinot, sallonet e masazheve, studio e modelimit të veshjeve të brendshme etj.

Më tutje janë diskutuar edhe temat: Mbledhja e provave kundër pronarëve të bizneseve, Kalimi nga prostitucioni në trafikim me njerëz, Hetimet e qendësuara tek viktimat (qasja pro-viktimë), Bashkëpunimi dhe Bashkërendimi Ndër-Institucional. Të gjitha këto u elaboruan përmes rasteve të studimit, shembujve praktik duke mundësuar diskutimin interaktiv dhe elaborimin e përbashkët të rasteve dhe formave të trafikimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë, prokurorë, polic dhe avokat.

Çka është Trafikimi me njerëz?

"Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të detyrimit..., me qëllim të shfrytëzimit"

POR ... Nëse viktima është nën moshën 18 vjeçare, nuk ka nevojë që të dëshmohet përdorimi i forcës, mashtrimi ose detyrimi

Tregtare = çdo gjë me vlerë

Prostitucioni dhe TNj janë të ndryshëm

E paktaefikuar

Trajnimi: Ndërmjetësimi

Më 16 Nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) në bashkëpunim me Programin e USAID – Drejtësia Komerciale implementuar nga CHECCHI and COMPANY realizuan trajnimin me temë “Zgjidhja Alternative e Kontesteve Ndërmjetësimi”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive për gjyqtarë të rinjë, lidhur me risitë që ka sjellë Ligji nr.06/-009 për Ndërmjetësimin.


Me rastin e këtij trajnimi u elaboruan rastet të cilat janë më të përshtatshme për tu referuar në procedurën e ndërmjetësimit e gjithashtu edhe referimi i lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e

palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Gjatë këtij trajnimi u prezantuan praktikat më të mira si dhe praktika e ndërmjetësimit në Kosovë duke vënë në pah edhe krahasimet e proceseve gjyqësore me ndërmjetësimin dhe përfitimet e palëve që zgjedhin zgjidhjen e rasteve përmes ndërmjetësimit.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë të sapo emëruar nga të gjitha regionet e Kosovës.



Program i Specializuar Trajnimi -Krimi kibernetik dhe provat elektronike-Sesioni III

Më 17-18 Nëntor 2020, në bashkëpunim me projektin IRZ, është realizuar trajnimi përmes platformës Zoom me temë “Program i Specializuar Trajnimi -Krimi kibernetik dhe provat elektronike-Sesioni III”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me krimet që kryhen përmes sistemeve kompjuterike ose krime të teknologjisë së lartë.

Gjatë këtij trajnimi u prezantuan temat: Konventa e Budapestit mbi krimin kibernetik, e drejta procedurale/masat hetuese sipas legjislacionit vendor, aktivitetet e paligjshme online, bashkëpunimi ndërkombëtar për krimin kibernetik dhe hetimin financiar dhe praktika

dhe procedura e provave elektronike. Vëmendje të veçantë gjatë trajnimit kishte edhe bashkëpunimi i nevojshëm ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit në mënyrë që të luftohet rritja e shpejtë e krimit kibernetik.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, paraqitja e këndvështrimeve të pjesëmarrësve, prezantimi përmes PowerPoint, pyetje-përgjigjet dhe analizimi i rasteve nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi janë: Gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit të apelit dhe niveli themelor.



Trajnim: Shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim


Me 17,18 dhe 19 nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës SHBA – OPDAT, ka realizuar trajnimin me temë “Shkathtësitë e përfaqësimit në gjykim”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e drejtë të fjalës hyrëse, shtrimit të pyetjeve të drejtpërdrejta, dhe fjalës përfundimtare të prokurorit të shtetit.

Gjatë këtij trajnimi në platformën Zoom u analizua çështja e zbatimit të shkathtësive të gjykimin në lidhje me paraqitjen prokurorit të shtetit në gjykimet penale. Një vështrim përmbajtësor iu bë analizimit të provave nga ana e prokurorit të shtetit të cilat duhet ti ketë

parasysh që nga fillimi i hetimit gjer në ngritjen e aktit akuzues sepse nga kjo do të varet edhe suksesi i tij në gjykim. Përmes elaborimit të rasteve praktike, vëmendje iu kushtua fjalës hyrëse, shtrimit të pyetjeve të drejtpërdrejta, atyre të tërthorta si dhe fjalës përfundimtare të cilat kanë rëndësi shumë të madhe për një përfaqësim të denjë të prokurorit në gjykatë dhe një rëndësi jo aq të vogël në suksesin e gjykimin.

Përfitues të këtij trajnimi ishin Gjyqtarë nga niveli Themelor – Divizioni Penal, Prokurorë nga Prokuroria Speciale, si dhe Prokurorë nga niveli Themelor.



Trajnim: Avancim mbi të drejtën e personave LGBTI në Kosovë

Më 18 Nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me CEL - Qendra për Barazi dhe Liri për të drejtat e komunitetit LGBTI në Kosovë realizoi trajnimin me temë “Avancim mbi të drejtat e personave LGBTI në Kosovë”.

Qëllimi i trajnimit ishte identifikimi adekuat i praktikës gjyqësore ndërkombëtare dhe vendore në lidhje me të drejtat e personave të komunitetit LGBTI dhe përqendrimi në rëndësinë e angazhimit të ndjekjeve penale për të luftuar krimin e urrejtjes të diskriminimit dhe paragjytimeve që personat e komunitetit LGBTI përjetojnë në Kosovë.

Me rastin e këtij trajnimit janë trajtuar identifikimi i fakteve ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë: orientimi seksual, identiteti gjinor, karakteristikat

seksuale, krimi i urrejtjes dhe konceptet më të gjera të homofobisë, transfobisë, stereotipizimit dhe “diskriminimit. Me theks të veçantë u trajtua aplikimi praktik i standardeve ndërkombëtare si dhe i legjislacionit lokal që duhet të mbështesin ndjekjen efektive të krimeve të urrejtjes ndaj personave të komunitetit LGBTI.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive duke shtjelluar edhe raste të ndryshme nga praktika gjyqësore.

Përfitues në këtë trajnim janë: gjyqtar të nivelit Themelor nga gjitha regionet e Kosovës.



Trajnim: Hetimet në Internet në rastet e trafikimit me njerëz dhe çështjet që ndërlidhem me format e shfrytëzimit të fëmijëve” -Sesioni 3

Më 18 nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Drejtësisë/OPDAT, ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë – “Hetimet në Internet në rastet e trafikimit me njerëz dhe çështjet që ndërlidhem me format e shfrytëzimit të fëmijëve” -Sesioni 3

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë lidhur me hetimet në internet dhe zbulimin e rasteve të trafikimit me njerëz dhe format e shfrytëzimit të fëmijëve.


Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan mediat sociale për të mbështetur deklaratat e viktimave të fëmijëve, intervistimi forenzik i fëmijëve adoleshentëve, çështjet që duhet pasur parasysh me rastin e intervistimit të viktimave dhe dëshmitarëve fëmijë. Gjithashtu u diskutuan tema edhe rreth Protokollit të intervistimit të FBI (CAFI), punët e fshehta në internet, sfidat e sigurimit të bisedave dhe informacioneve etj.

Theksi i trajnimit ishte në mënyrën e fillimit të intervistës, fazat e intervistës, rregullat themelore të krijimit të raporteve të mira gjatë intervistimit si dhe çka “nuk” duhet të bëhet gjatë intervistimit të fëmijëve.

Pjesëmarrësit në trajnim patën rastin e diskutimit të shembujve praktikë të identifikimit të rasteve përmes rrjeteve sociale.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, paraqitja e këndvështrimeve të pjesëmarrësve, prezantimi përmes PowerPoint, pyetje-përgjigjet dhe analizimi i rasteve nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë nga gjykata Themelore, prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të shtetit dhe nga prokuroria Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës, mbrojtës të viktimave nga Zyra e Avokatit të Viktimave, polic nga Njësia për Hetimin e Njesisë së Trafikimit me Njerëz, dhe staf administrativ nga gjyqësori dhe prokuroria.



Angazhimi i fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara

Më 19 nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me ILO - Organizata Ndërkombëtare e Punës, ka realizuar punëtorinë përmes platformës Zoom me temë “Angazhimi i fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara”.


Qëllimi i kësaj punëtorie ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mitur për angazhimin e fëmijëve në forma të rënda të punës dhe punë të detyruara dhe zbatimi i drejtë i dhe dispozitave gjyqësore në rastet e tilla.

Me rastin e kësaj punëtorie u elaboruan format e ndryshme të angazhimit të punëve të rënda të fëmijëve dhe njëkohësisht korniza ligjore vendore dhe ndërkombëtare që i sanksionojnë veprat e tilla me theks të veçantë Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e gjithashtu edhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila i

ka të integruara instrumentet ndërkombëtare që garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjate punëtorisë u trajtuan çështjet si: Çfarë është puna e rëndë e fëmijëve?, a i ndalohe fëmijës që të punoj?, çka ndikon dhe sa është e përhapur keqpërdorimi i punës së fëmijës?, si përkufizohet puna e lehtë e fëmijëve? si dhe u analizuan raste nga praktika duke i adresuar gjitha çështjet më sfiduese në zgjidhjen e rasteve ligjore.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, paraqitja e këndvështrimeve të pjesëmarrësve, pyetje-përgjigjet dhe analizimi i rasteve nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi janë: Gjyqtarët dhe prokurorët nga Departamenti për të mitur.



Tryezë me gjyqtarë dhe avokat –Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështje civile

Më 20 Nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e BE Mbështetje Kodit Civil Faza 2, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme realizoi Tryezën përmes platformës Zoom me temë “Harmonizimi i vendimeve të gjykatave në çështje civile”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte harmonizimi dhe unifikimi i vendimeve të gjykatave në çështje civile.


Gjatë kësaj tryeze u trajtuan Risetë e Kodit Civil në librin e parë (pjesa e përgjithshme) si dhe Krijimi dhe harmonizimi i rregullave të përgjithshme në Kodin Civil.

Në mënyrë të hollësishme u trajtuan mënyrat eventuale të zbatimit të Kodit Civil me qëllim

që të sigurohet zbatimi unik i tij në tërë vendin për rastet e ngjashme në mënyrë që të shmangen situatat sikurse që kanë ndodhur deri më tani, ku për çështje të ngjashme, gjykatat kanë marrë vendime të ndryshme me njëra tjetrën.

Pjesëmarrësit gjatë tryezë patën rastin e diskutimeve dhe komentimit të vendimeve gjyqësore të cilat janë paraqitur në praktikë dhe në këtë mënyrë të zërthejnë dispozitat ligjore të cilat janë risi nga Kodi Civil i Republikës së Kosovës.

Përfitues të këtij trajnime ishin: gjyqtar nga të gjitha Regjionet e Kosovës.



Trajnim: Liria e shprehjes dhe mbrojtja nga shpifja-neni 10 i KEDNJ-së

Më 24-25 nëntor 2020 në bashkëpunim me Projektin e Bashkimit Evropian “Liria e Shprehjes dhe Liria e Mediave në Kosovë (JUFREX 2 është realizuar trajnimi dyditor online me temën: “Liria e shprehjes dhe e informimit - neni 10 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në temat e: Lirisë së shprehjes në kontekstin e debatit publik; Roli i lirisë së shprehjes dhe informacioni i disponueshëm për publikun; Rëndësia e lirisë së shprehjes dhe respekti për pushtetin gjyqësor si dhe detyrimet pozitive të shtetit sipas nenit 10 të KEDNJ.

Në këtë trajnim në ditën e parë u trajtuan temat në vijim: Prezantim i konceptit të lirisë së shprehjes dhe shpifjes (Neni 10 i KEDNJ-së dhe kufizimet e arsyeshme, Diskutim i disa deklaratave, Reputacioni, kritika e ashpër, kritika ofenduese, paditë SLAPP, Faktet, Opinionet dhe urdhëresat gjyqësore); Shpifja dhe figurat publike (Piramida e mbrojtjes nga shpifja -standardet vendore dhe ndërkombëtare, Standardet e GJEDNJ-së- parimet dhe kriteret që duhen zbatuar, testi 3 hapësh dhe testet tjera relevante; Legjislacioni vendor (Si definohet shpifja dhe fyerja? Çfarë ka të drejtë të kërkojë personi përmes procedurës gjyqësore? Kush e ka barrën e të provuarit? A mund të dënohesh për shpifje nëse shpreh një opinion? Në cilat raste deklaratat e bëra nuk bartin përgjegjësi?). Ndërsa në ditën e dytë janë trajtuar: Përgjegjësitë e gazetarëve dhe sanksionet kundër tyre (Gazetaria e përgjegjshme, përjashtimi nga obligimi për të verifikuar faktet, kufizimi në përdorimin e legjislacionit penal, mjetet juridike alternative), Prezantim i rasteve penale që përfshijnë gazetarët Shembuj të

rasteve kur gazetarët kanë nxitur dhunë, kanë bërë deklaram të rremë, Prezantim i rasteve të shpifjes që përfshijnë gazetarët dhe mediat, Shembuj/aktgjykime të rasteve të shpifjes të gjykuara nga gjykatat vendore; Roli i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Komisionit të Pavarur për media në rastet e shpifjes dhe zbatimi i standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në praktikë.

Në vazhdim të trajnimit u zbërthyen dispozitat e nenit 10 të KEDNJ: Liria e shprehjes që është rregulli i përgjithshëm (paragrafi 1 i neni 10), Kufizimet e lirisë së shprehjes e që janë përjashtim (paragrafi 2 i nenit 10), Testi tre hapësh, dhe Margjina e vlerësimit. Lidhur me shpifjen u zbërthyen nocionet e reputacionit, privatësisë (neni 8 dhe 10), dallimi në mes të fakteve dhe opinioneve, kritika e ashpër, efekti frenues dhe mbrojtja nga shpifja (e vërteta, shprehjet politike, satira, opinionet, interesi publik, shpifja dhe sanksionet jo-proporcionale).


Me dobi ishte edhe zbërthimi i Padive SLAPP - Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (Strategic Lawsuits Against Public Participation -SLAPP). Këto padi u theksua se përdoren nga politikanët dhe biznesmenët e fuqishëm, të cilët nëpërmjet këtyre padive që nuk kanë bazë dhe shans për sukses, kërkojnë nga gazetarët, mediat dhe aktivistët mijëra e deri në miliona euro dëmshpërblime në emër të “cenimit të reputacionit” krejt kjo me qëllim të frikësimit apo zbrapsjes së gazetarëve në drejtim të hulumtimit dhe publikimeve të dukurive kriminale në shoqëri.

Në këtë trajnim u zbërthyen edhe materialet dhe modulet e reja dhe praktika gjyqësore aktuale e GJEDNJ në kontekstin e lirisë së shprehjes dhe debatit publik. Në pjesën e fundit u trajtuan dhe u analizuan disa raste shumë të dobishme nga praktika gjyqësore në Republikën e Kosovës ku morën pjesë të gjithë pjesëmarrësit.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, interpretime të thelluara të ligjit, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore vendore dhe ajo e GJEDNJ

në Strasburg të shoqëruara me diskutime interaktive dhe interpretime të dispozitave të KEDNJ, Ligjit Kundër Shpifjes dhe Fyerjes dhe dispozitave tjera në fuqi që rregullojnë këtë tematikë. Trajnimi u përmyll pas një debati produktiv me sqarimet dhe përfundimet e trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë si dhe staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive nga gjitha regjionet e Kosovës.



Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Trajnimi: Integriteti dhe sjelljet etike

Më 19 nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Integriteti dhe sjelljet etike”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi në respektimin e sjelljes etike dhe vendosjen e standardeve të integritetit moral dhe udhëzimeve për sjellje të hijshme personale dhe profesionale të stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial.


Gjatë këtij trajnimi u trajtuan çështjet rreth administratës gjyqësore dhe prokuroriale në Kosovë me theks të veçantë sjelljet etike. Me rastin e këtij trajnimi u theksua që prioritet i sistemit gjyqësor dhe prokurorial, është rritja e cilësisë së performancës profesionale, duke siguruar zbatimin e duhur praktik të parimeve dhe standardeve etike në përputhje me Kodin e Etikës siç janë: profesionalizmi, disiplina në punë, paanësia, pavarësia, konfidencialiteti,

shmangia nga konflikti i interesit dhe nga sjelljet e pa hijshme, ndershmëria dhe llogaridhënia.

Në vazhdim gjatë trajnimit mes tjerash u vu në pah se për të pasur një imazh të mirë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial ka nevojë që të ketë staf administrativ i cili duhet të respektojë rregullat dhe standardet etike jo vetëm gjatë kohës sa është në zyre në orarin e punës, por edhe jashtë zyrës pas orarit të punës, sepse ata paraqesin pasqyrën e të punësuarve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive nga gjitha regionet e Kosovës.



Aktivitetet për Trajnimin e Trajnuesve

Trajnimi për Trajnues në drejtësinë komerciale

Më datë 24-27 Nëntor 2020, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Checchi&Company Consulting Inc., si implementuese e Programit për Drejtësi Komerciale brenda Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), ka zhvilluar sesionin e I-rë të Trajnimit të Trajnuesve në fushën e Drejtësisë Komerciale.

Ky trajnim ka ardhur si rrjedhojë e hulumtimeve dhe identifikimit të nevojave trajnuese në këtë fushë, si dhe proceseve ligjore të cilat janë në rrugë e sipër, si krijimi i Gjykatës Ekonomike në Kosovë.

Qëllimi i këtij trajnimit ishte që të krijohet një kuadër i kualifikuar dhe i profesionalizuar i trajnuesve në fushën Komerciale, të hartohet një kurrikulë gjithëpërfshirëse e trajnimit në fushën komerciale, përmirësimi dhe harmonizimi i legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar në aspektin tregtar etj.

Sesioni i parë Trajnues ka pasur kohëzgjatje prej 4 ditësh dhe fillimisht janë diskutuar çështjet themelore të trajnimit si: Metodologjia e Trajnimit, Teknikat dhe struktura e trajnimeve, dizajnimi i objektivave SMART, arsyetimi ligjor etj.

Në ditën e III dhe IV, trajnimit iu kanë bashkëngjitur edhe dy (2) gjyqtarë komercial nga Gjermania, të cilët shpalosën praktikrat dhe përvojat e tyre trajnuese, sidomos në fushën e Aftësive ligjëruese, dhe aspektet praktike nga Falimentimi, si dhe aspektet teknike të ndarjes së lëndëve në Gjykatat në Gjermani, afatet për shqyrtimin e një lënde, Ankesat etj.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit janë ndarë në grupe, secili me punë specifike në zhvillimin e draft moduleve të trajnimit dhe planin e punës për dizajnimin e modulit.



Trajnimi i trajnuesve në fushën e të drejtës Komerciale pritet t'i ketë 3 sesione trajnuese me nga 4 ditë trajnimit dhe përfitues të saj janë 18 kandidatët e përzgjedhur nga procesi i rekrutimit që ka zhvilluar Akademia e Drejtësisë paraprakisht.



I tërë trajnimi është zhvilluar në mënyrë interkative mes trajnueses dhe pjesëmarrësve.


Për shkak të situatës së krijuar nga virusi COIDV-19, trajnimi është zhvilluar në platformën elektronike ZOOM.




Vijueshmëria në trajnime në PTV e prezantuar përmes grafikoneve








Nr. i trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive Nëntor 2020



Nr. i trajnimeve dhe i pjesëmarrjes në TiT Nëntor 2020



Kurset e mësimit në distancë-Elearning

Gjatë muajit nëntor platforma e mësimit në distancë ka vazhduar të jetë e hapur për pjesëmarrësit e interesuar (Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive si dhe për studentët e Fakulteteve Juridike) pa afat të caktuar kohor.

Në kuadrin e kësaj platforme janë 19 kurse të çashtme online, 11 prej të cilave edhe në gjuhën serbe.

Më 20 korrik 2020, sipas Rregullores së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Nr. 06/2019) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Nr. 06/2017) është lëshuar online edhe kursi obligativ “Etika profesionale” për gjyqtarët e Republikës së Kosovës.

Për në detaje janë tabelat të cilat prezantojnë vijueshmërinë dhe progresin në ndjekjen e kurseve sipas temës në këtë platformë.

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore (Shqip)</i>	225	77%	40	14%	28	10%
<i>Etika Profesionale I</i>	230	78%	48	16%	15	5%
<i>Etika Profesionale II</i>	243	83%	23	8%	27	9%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore (Serbisht)</i>	28	10%	17	6%	248	85%
<i>Etika Profesionale I (Serbisht)</i>	25	9%	86	29%	182	62%
<i>Etika Profesionale II (Serbisht)</i>	6	9%	50	17%	217	74%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Masat e Diversitetit</i>	3	3%	11	10%	99	88%
<i>Masat e Diversitetit (Serbisht)</i>	0	0	0	0	13	100%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi Efektiv</i>	3	18%	12	71%	2	12%
<i>Menaxhimi Efektiv (Serbisht)</i>	0	0	0	0	13	100%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Drejtesia për fëmijë aspekti Civil</i>	18	16%	19	17%	76	67%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Drejtesia për fëmijë aspekti Penal</i>	10	9%	16	14%	87	77%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Hetimi dhe zbulimi i Korrupsionit</i>	12	11%	9	8%	92	81%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Korrupsioni sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar</i>	7	6%	7	6%	99	88%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi i Gjykatës</i>	13	12%	6	5%	94	83%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Udhëheqësia - Lidershipi</i>	11	10%	9	8%	93	82%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike Shq (Shqip)</i>	9	8%	19	17%	85	75%
<i>E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Serbisht)</i>	3	23%	5	38%	5	38%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Shqip)</i>	20	18%	15	13%	78	69%
<i>Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Serbisht)</i>	2	15%	4	31%	7	54%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi i stresit (Shqip)</i>	38	34%	20	18%	55	49%
<i>Menaxhimi i stresit (Serbisht)</i>	6	46%	3	23%	4	31%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Shkathësitë e komunikimit social (Shqip)</i>	9	8%	8	7%	96	85%
<i>Shkathësitë e komunikimit social (Serbisht)</i>	2	15%	4	31%	7	54%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Trajnimi për implementimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Shqip)</i>	7	6%	6	5%	100	88%
<i>Trajnimi për implementimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Serbisht)</i>	2	15%	3	23%	8	62%


Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Shqip)</i>						
<i>Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Serbisht)</i>	1	15%	4	31%	7	54%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Anglishtja Ligjore</i>	39	35%	23	20%	51	45%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Teknologjia Informativë</i>	32	28%	14	12%	67	59%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Dhuna në Familje (Shqip)</i>						
<i>Dhuna në Familje (Serbisht)</i>	0	0%	3	12%	22	88%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Mbajtja e shënimeve për Interpret Gjyqësor</i>	3	38%	5	63%	0	0%
<i>Mbajtja e shënimeve për Interpret Gjyqësor (Serbisht)</i>	0	0%	2	25%	6	75%



Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660
E-mail: infoad@rks-gov.net
<https://ad.rks-gov.net>